



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 379/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ferki Xhaferi kryesues, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Gentiana Krasniqi duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore-dërgim i sms me thirrje për votim, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të datës 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë.15.02.2021, mori këtë:

VENDIM

KONSTATOHET tërheqja e ankesës Anr.379/2021 e datës 14.02.2021, e parashtruar nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

Arsyetim

Me datë 14.02.2021, PZAP-i ka pranuar ankesën Anr.379/2021 të datës 14.02.2021 nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me të cilën pretendon se në ditën e zgjedhjeve (e diel, 14 shkurt 2021), kanë dërguar mesazhe (sms) përmes telefonit me thirrje për të votuar “AAK, Nr.135, voto R. Haradinaj për President”, duke bërë shkelje të ligjit Nr.03/L-073, për Zgjedhjet e Përgjithshme. Lidhja Demokratike e Kosovës për shkeljen e supozuar është njoftuar me datë 14.02.2021, andaj brenda afatit prej 24 ka parashtruar ankesë në PZAP. Si dëshmi krahas kësaj ankese i ka bashkangjitur si provë fotografi me sms-in e dërguar me thirrje për votim dhe i ka propozuar PZAP-së që ndaj subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), të aplikohet rregulla Nr.01/2012 për Kategorizimin e Sanksioneve dhe Gjobave, respektivisht neni 6 par.6.2.

Me datë 14.02.2021, ankuesi ka parashtruar kërkesën me nr. Protokolli 379/3 për tërheqjen e ankesës Anr.379/2021, të datës 14.02.2021 për shkak të thyerjes së heshtjes zgjedhore-dërgim i sms me thirrje për votim.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës, në kuptim të nenit 11 paragrafi 2 të Rregullën Nr.02/2015 të PZAP-it si dhe nenit 115.1 të LZP -së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.379 /2021 më datën 15.02.2021

Kryesues i Panelit
Ferki Xhaveri

